



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 29570 Prot.

Tiranë, më 19/12/2016

MANUAL UDHËZUES

Nr. 10 datë 19/12/2016

“Mbi zbatimin e procedurave për transitin e përbashkët Shqipëri - Kosovë”

Mbështetur në Marrëveshjen Kuadër Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunimin në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë, bërë në Prizren, më 11 janar 2014, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 223, datë 23.4.2014;

Me qëllim miratimin e detajeve teknike dhe procedurale, për realizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Doganës së Republikës së Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë Nr. 14956, datë 19.06.2014;

Me synim lehtësimin e procedurave të transitit të mallrave nga dhe me destinacion Republikën e Kosovës, si dhe,

Bazuar në nenin 233 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor, të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

UDHËZON:

I. Të përgjithshme

1. Procedura e Transitit të Përbashkët ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës do të kryhet duke përdorur një deklarim Transit dhe një garanci të vetme për mbulimin e lëvizjes.
2. Në Sistemin Asycuda World, deklarata për kryerjen e procedurës së Transit të përbashkët Shqipëri - Kosovë, do të plotësohet me T2 (kutia 1/3 e deklaratës)

3. **Zyrë Doganore e Nisjes** do të quhet zyra doganore ku kryhet pranimi i deklarimit përvendosjen e mallrave nën procedurën e transitit të përbashkët.
4. **Zyrë Doganore Transit (zyrë kalimi)** do të quhet zyra doganore (e parë) ku mallrat hyjnë në territorin doganor të palës tjetër kontraktuese.
5. **Zyrë Doganore Destinacioni**, do të quhet zyra doganore ku duhet të paraqiten mallrat me qëllim mbylljen e procedurës transit.
6. **Principal**, do të quhet personi kryesor përgjegjës përvendosjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit afatit kohor të përcaktuar, në përputhje me kërkesat e legjisacionit në fuqi. Gjithashtu, principali siguron mbulimin me garanci të detyrimeve doganore që duhet të paguhen në rast se mallrat do të vendoseshin në qarkullim të lirë.

II. Veprimet në Zyrën Doganore të Nisjes

1. Në rastet kur një lëvizje transit e mallrave fillon nga një zyrë doganore nisje në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë përvendosjen e mallrave në zyrën doganore destinacioni në Republikën e Kosovës, do të veprohet si më poshtë vijon:

Përfaqësuesi i tërthortë/i drejtpërdrejtë depoziton deklaratën doganore të plotësuar me të gjitha të dhënat e nevojshme në sistemin Asycuda World, duke përdorur modulin e transitit (Fig.1)




Figura. 1, Moduli transitit

2. Plotësimi i deklarimit transit do të kryhet si normalisht, përvèç ndryshimeve të mëposhtme:
 - Kutia 1/3 (Fig. 2), plotësohet T2 (Transit i përbashkët).

		A ZYRA DOGANORE	
		AL140000 ▽	
		Durrësi	
1 DEKLARATE		T2	
3 Formular		4 Liste ng...	
1	1		
5 Artikuj	6 Koli gjithsej	7 Numer reference	
1	11	2016	
Numri i Tranzitit			

Figura.2 - Tipi T2

- Në kutinë 8 do të shënohet kodi i identifikimit të Marrësit/Importuesit nga Kosova (Fig.3)

8 Marrës/Impor...	Nr 000055093	Numri i Tranzitit
FONDI MONETAR NDÉRKOMBËTARE RRUGA GARIBALDI NR.33		
14 Deklaruesi/Përtaqësuesi Lorin & CO Terminali Doganor Vore Vore	Nr J022	15 Vend i dërguesa/eksportues Albania
		16 Kod.L. V. derg./... a) AL b) KK
		17 Kodi. V. desti... a) KK b) KK
		17 Vend i destinacionit Kosova
		Invoice value

Figura. 3 - Marrësi/importuesi

- Në rastet kur ka më tepër se një pritës malli (mallra me destinacion pritës/importues të ndryshëm), kutia 8 do të plotësohet me shënimin “Grupazh” dhe kodin e identifikimit K0000000S.
 - Në kutinë 31 të T 2-it, është i detyrueshëm plotësimi i numrit të kodit të identifikimit të Marrësit (Fig. 4)
3. Në rastet e ngarkesave grupazh, në secilën prej kutive 31 do të shënohet kodi përkatës i identifikimit të pritësit të mallrave.

4	5		
31 Koli të dhë përshtkritimi i mallrave 31 L4 B1	Markat dhe numrat - Nr. i kontenierve - Sasia dhe lloji NIP/T 000055093 i pakove Nr dhe lloji 11 91 Paleta	32 Artikull 1 Nr	33 Kodi tarifor 84162020
	Nr e kontenierve --- Furra te kombinuara		40 Deklarata pi

Figura. 4, Marrës/importuesi i mallrave

- Kutia 53 e Deklaratës, do të plotësohet me kodin e zyrës doganore të destinacionit. Pra, kur lëvizja transit ka nisur nga një zyrë doganore shqiptare, në këtë kuti do të shënohet kodi i zyrës doganore kosovare ku do të mbërrijnë mallrat (Fig.5).

10,000	Kodi	53 Zyre e destinacionit dhe vendi 2020	ZBD PRISHTINE
Vula:			XK

Limiti kohor _____ Nenshkrimi dhe emri i deklaruesit/ perfaqesuesit

Figura.5 – Plotësimi i Zyrës së destinacionit

4. Procedura e deklarimit të Transitit të përbashkët do të realizohet vetëm nëpërmjet mbulimit me garanci.

Garancia fiksohet/përllogaritet duke krahasuar detyrimet doganore dhe pagesat e tjera që duhet të paguhen në Republikën e Shqipërisë me ato që duhen paguar në Republikën e Kosovës dhe nga ky krahasim përzgjidhet shuma më e lartë.

Principali është i regjistruar në sistemin Asycuda World, po kështu edhe garancia bankare e depozituar për këto operacione.

Sistemi kontrollon nëse ngarkesa është e mbuluar nga garancia e regjistruar.

5. Pasi deklarata T2 është plotësuar dhe depozituar, sistemi kryen automatikisht kontrollin e të dhënavë të saj (kodin e marrësit, kodin e principalit, vlefshmërinë e garancisë, zyrën e principalit, zyrën e transitit, si dhe zyrën e destinacionit) Deklarata e Transitit T2 merr një nr. reference lokale në sistemin Asycuda World.
6. Në momentin e regjistrimit të T2 në sistem, (përpara marrjes së NRN-së) në varësi të profitit të përzgjedhur nga Analiza e Riskut, autoritetet doganore në zyrën e Nisjes, do të kryejnë kontrolllet dhe verifikimet e nevojshme:
 - verifikim të dokumentacionit,
 - skanim,
 - kontroll fizik të mallrave

Pas përfundimit të kontrolleve apo verifikimeve të mësipërme, doganieri përgjegjës plotëson rezultatet e kontrollit dhe vijon normalisht punën me futjen e mallrave në regjin e transitit, kontrollon/kryen plumbosjen e mjetit, plotëson deklarimin me numrin dhe identitetin përkatës të plumbçeve duke caktuar edhe afatin (limitin) kohor të nevojshëm për mbërritjen në destinacion të mallrave.

Afati kohor për mbërritjen e mallrave në zyrën e destinacionit, përllogaritet duke mbledhur kohën e përcaktuar për mbërritjen e transitit në zyrën doganore të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë (sipas Udhëzimit nr. 4, datë 30.09.2011, DPD nr. prot 16105, datë 30.09.2011) me kohën e përcaktuar për mbylljen e procedurës së transitit në zyrën e destinacionit në territorin doganor të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në Aneksin 2, pjesë përbërëse e këtij Manuali.

Kur deklarimi transit T2 regjistrohet në sistemin Asycuda WORLD, ky i fundit gjeneron edhe numri NRN të kësaj lëvizje.



Figura.6 - Numri NRN

III. Veprimet në Zyrën Doganore të Transitit

- Me mbërritjen e mallrave në zyrën doganore të Transitit (p.sh. Vermicë në rastin e nisjes së një lëvizje transit nga Republika e Shqipërisë), doganieri kosovar përgjegjës do të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme doganore si dhe veprimet përkatëse në sistem.
Në rast se lëvizja transit ka filluar nga një zyrë doganore Kosovare me destinacion Republikën e Shqipërisë, rolin e zyrës transit do ta luajë zyra doganore Morin Kukës.
- Veprimet që duhet të kryhen për një transit të regjistruar në Kosovë janë si më poshtë:
 - Doganieri hyn në sistemin Asycuda WORLD (shqiptar) në Modulin e Transitit - Zyrë Destinacioni – Kërko (sipas kriterit të përzgjedhur) – lista e T2 (Fig.7)

V#	Zyra e Ns...	Data e regjistrimit	Numri i Regjistrimit	Declarante	Refer	Zyra e De...	Dat...	Nu...	Data limit	Date e mb...	Targa e m...	Tra...	Kodi i garancise	Principal Kanal	P. Kanal	Tipi
2	2040	05/12/2016 00:00	16ALT220400000	6001600	#1	AL110000			07/12/2016		AA12388		TRSG00160080	600160	Green	1
3	2040	05/12/2016 00:00	16ALT220400000	6001600	#2	AL110000	15	1	07/12/2016	08/12/2016	AA12388		TRSG00160080	600160	Green	2

Figura.7- Gjetja e T2

- Pasi gjendet deklarata T2 që i përket ngarkesës (bazuar në NRN e lëvizjes), doganieri klikon në rubrikën CTS Cross Border (Fig. 8) e cila hap deklaratën e transitit.




Figura. 8 - CTS cross border

- Pas hapjes së deklaratës T2, klikohet në kuadratin CTS cross border (veprim i detyrueshëm) si Fig. 9, më poshtë.

4	5	2 Dërgues/Eksportuesi Kosova Tabaco Group	Nr _____
		3 Formular	
		1	T2
		4	Liste nr...
		5 Artikuj	6 Koli gjithsej
		1	1
		7 Numer reference 2016 #2	
		8 Marrëveshimi... DIVA - AL Rr.ALEKSANDER GOGA, PALL.535, L-18 Nr. DURRES KOSOVA	
		Nr. K81328501A	
		Numri i Tranzitit T 16XKT2204000000476 06/12/2016	

Figura. 9 - CTS cross border

Kujdes: Veprimet e mësipërme në zyrën doganore të transitit (Morin Kukës - zyra hyrëse në territorin shqiptar) janë detyruese, përndryshe nuk mund të kryhet mbyllja e transitit T2 në zyrën e destinacionit në territorin shqipëtar (Fig. 10)

Dokumenti Tranzitor Doganor						A ZYRA DOGAHORE 2040 ZBD PRIZREN	
4	5	2 Dërguesi/Eksportuesi Kosova Tabaco Group	Nr	1 DEKLARATE T2	3 Formular 1 1	4 Listë ng. 1	
		8 Marrës/Impor... DIVA AL Rr.ALEKSANDER GOGA, PALL.535, L.18 Nr.	Nr K81328501A	5 Artikuj 1	6 Koli gjithsej 1	7 Numer reference 2016 #1	Numri i Tranzitit T 16XKT2204000000468 06/12/2016
<input type="checkbox"/> Mesazhet Gabim: You are not allowed to do operations on T2 which NOT crossed border Gabim: Data e mberritjes, karkohen te dhena							

Figura. 10 - Pamundësi mbyllje në doganën e destinacionit të transitit T2

V. Veprimet në Zyrën Doganore të Destinacionit.

1. Kur ngarkesa mbërrin në zyrën doganore të Destinacionit transportuesi paraqitet pa vonesë pranë autoritetit doganor.
2. Doganieri përgjegjës në zyrën doganore shqiptare të destinacionit kryen normalisht në sistem të gjitha veprimet për mbylljen e transitit.

Doganieri përgjegjës i zyrës doganore të destinacionit pasi verifikon identitetin, gjendjen e mjetit të transportit dhe të plumbçeve kryen normalisht të gjitha hapat proçeduriale për mbylljen korrekte të transitit T2 në Asycuda WORLD. (Fig. 11, 12)




Figura. 11 - Mallra në mbërritje




Figura. 12 - Kontrolli i plumbceve

3. Mbyllja në sistem në mënyrën e duhur të transitit, mundëson çlirimin e garancisë.

VI. Ndryshimi i Zyrës Doganore të Deklaruar të Destinacionit (Devijimi)

Nëse për ndonjë arsy, mjeti që shoqërohet me transitin T2 nuk ka mundësi të paraqitet në zyrën doganore të destinacionit, të përcaktuar në kutinë 53 të deklaratës, është i mundur ndryshimi i zyrës së destinacionit. Ky ndryshim mund të kërkohet nga transportuesi, si në momentin kur dërgesa kalon në zyrën doganore të transitit, po ashtu edhe në zyrën e re të destinacionit. Për këtë duhet që, në përputhje me rregullat në fuqi, të njoftohet zyra doganore e nisjes për të kryer ndryshimet në sistem.

VII. Dispozita lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin

1. Në rastet kur, për arsyet përcaktuara në dispozitat e Titullit I, "Transiti", Pjesa II, "Destinacionet Doganore" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999, të ndryshuar, ka devijim nga itinerari apo vonesa gjatë transitit nga zyra doganore e nisjes deri në zyrën doganore të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, zbatohen sipas rastit dhe me rregullimet e nevojshme të gjitha procedurat e përcaktuara në dispozitat e këtij Titulli, si nga ana e personave apo operatorëve ekonomik ashtu edhe nga autoritetet doganore.
2. Kur konstatohen shkelje brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, gjatë ose në lidhje me transitin, përcaktimi dhe vjelja e detyrimeve doganore, pagesave të tjera që duhen paguar apo sanksioneve respektive nëse janë të aplikueshme, bëhet nga Autoritetet Doganore Shqiptare. Në këto raste këto Autoritete marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndjekur shkeljet ose parregullsitë e rastit, procedurat për evidentimin e tyre dhe të vendosin ndëshkimet e duhura, në bazë dhe zbatim të Kodit Doganor.
3. Informacioni në lidhje me pikat 1 dhe 2, i transmetohet dhe/ose paraqitet Autoritetetve Doganore të Republikës së Kosovës.

VIII. Dispozita të fundit

Ky Manual Udhëzues paraqet të gjitha ndryshimet lidhur me T2 në ASYCUDAWorld, ndërkohë që të gjitha hapat e tjera kryen normalisht sipas Instruksionit mbi Procedurën Transit të T1.

Ky Manual Udhëzues hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



Aneksi Nr. 1

Kodi	Zyra Doganore
2020	ZBD PRISHTINE
2030	ZBD MERDARE
2032	ZD HANI ELEZIT-TERMINAL
2040	ZBD PRIZREN
2041	PKK VERMICE
2050	ZBD INTEREUROPA
2060	ZBD FERIZAJ
2070	ZBD MITROVICE
2080	ZBD PRISHTINA 3
3011	PKK KULLE
3012	PEJA TERMINAL
3023	PKK BERNJAK
3024	PKK JARINJE
3031	PKK MERDARE
3041	PKK DHEU I BARDHE
3042	DHEU I BARDHE TERMINAL

ANEKSI 2. Koha orientuese pérmbyllien e procedurës se transitit.

	7 h	7 h	5 h	5 h	7 h	6 h	7 h	7 h	8 h	6 h	6 h	2 h	5 h	5 h	5 h	5 h	5 h	5 h	24 h
PKK Kulla 3011																			
ZD Aeropori 2011	4 h	4 h	3 h	3 h	5 h	4 h	3 h	4 h	5 h	5 h	5 h	4 h	4 h	5 h		1 h	3 h	5 h	5 h
PKK Aeropori 2012	4 h	4 h	4 h	3 h	3 h	5 h	4 h	3 h	4 h	5 h	5 h	4 h	4 h	5 h		1 h	3 h	5 h	5 h
ZBD Intereuropa 2050	4 h	4 h	4 h	3 h	3 h	4 h	4 h	3 h	4 h	4 h	5 h	5 h	5 h	5 h		1 h	1 h	3 h	5 h
ZBD Ferizaj 2060	2 h	2 h	4 h	4 h	5 h	4 h	5 h	4 h	4 h	4 h	4 h	4 h	4 h	5 h		3 h	3 h	5 h	5 h
Qafa e Prushit 2043	6 h	6 h	6 h	5 h	5 h	7 h	5 h	6 h	7 h	7 h	7 h	4 h	4 h	5 h		5 h	5 h	5 h	5 h
Morina 2044	6 h	6 h	6 h	5 h	5 h	7 h	6 h	6 h	7 h	7 h	7 h	8 h	4 h	3 h		5 h	5 h	5 h	5 h
Gjakova 2045	6 h	6 h	6 h	5 h	5 h	7 h	5 h	6 h	6 h	7 h	7 h	7 h	3 h	3 h		5 h	5 h	5 h	24 h